

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Numri i Dokumentit: 12
Data e Emrimit: 07. 01. 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË



Datë: 07/01/2026

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe nenin 17 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera nr. 04/L-027, nenin 44 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (e) dhe nenin 44 të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës me Nr.98 të datës, 17.08.2012 nxjerr:

VENDIM PËR NGRITJEN E SHTABIT EMERGJENT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Neni 1

Ngritët Shtabi Emergjent për mbrojtje dhe shpëtim, për menaxhimin krizave në nivel Komune, në këtë përbërje:

Valon Prebreza , Kryetar i Komunës	Kryesues
Izja Mjeku , Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike	Koordinator
Shpend Bardiqi , Nën-Kryetar i Komunës	Anëtar
Taulant Kelmendi , Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban	Anëtar
Durim Hajra , Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit	Anëtar
Albana Gashi , Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë	Anëtar
Arianit Tërmkolli , Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës	Anëtar
Bardhyl Koçiçi , Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave	Anëtar
Adriatik Zeqiri , Drejtor i Drejtorisë së Arsimit	Anëtar
Ejup Qyqalla , Shef i Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Publike	Anëtar
Faik Dedinca , Shef për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Drejtorinë e Bujqësisë	Anëtar
Bekim Zogiani , Komandant i Stacionit Policor në Komunën e Fushë Kosovës	Anëtar
Abaz Xhigoli , Drejtor i Qendrës për Punë Sociale	Anëtar
Albion Demiri , Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun në Zyrën e Kryetarit	Anëtar

Neni 2

Shtabi Emergjent vepron në funksion të menaxhimit të situatës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera eventuale (reshje, vërshimeve, përmytjeve, zjarreve, tërmete, rrëshqitjeve të dheut e të tjera të ngjashme) në pajtim me ligjin dhe aktet tjera përkatëse të kësaj natyre si dhe koordinon ngushtë punët dhe aktivitetet me Agjencia Menaxhimit Emergjent - AME

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akti ju dërgohet: Anëtarëve të Shtabit, AME-së (për njofim), Arkivit.

